



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

Prezenca në Shqipëri

REKOMANDIMET E PREZENCËS SË OSBE-SË PËR PROJEKTLIGJIN E MBIKËQYRJES PARLAMENTARE TË SHËRBIMEVE INFORMATIVE DHE TË SIGURISË

Në vazhdim të kërkesës të Kryetarit të Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ofroi ndihmë në hartimin e një projektligji për kontrollin parlamentar të shërbimeve informative dhe të sigurisë. Kjo është pjesë e Projektit të Prezencës në Mbështetje të Parlamentit, financuar nga Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta.

Një ish-punonjës i specializuar i Komisionit parlamentar britanik për Shërbimet Informative dhe të Sigurisë, së bashku me personelin e OSBE-së, kanë punuar për të siguruar disa rekomandime për t'iu paraqitur kryetarit dhe anëtarëve të komisionit nga të gjitha partitë politike, anëtarëve të institucioneve dhe të shoqërisë civile, para hartimit të projektligjit. Objektivi i tyre është të ndihmojnë për prodhimin e një versioni të parë të projektligjit që forcon procedurat parlamentare, edhe nëpërmjet proceseve të konsultimit me publikun. Projektligji rregullon kontrollin e parlamentit mbi punën e shërbimeve informative dhe atyre të sigurisë. Ky ligj është i ndryshëm dhe më vete nga Ndryshimet në Ligjin për Shërbimin Shtetëror Informativ, të cilat janë debatuar së fundmi publikisht.

Rekomandimet bazohen në parimin se kontrolli parlamentar i shërbimeve kombëtare të sigurisë dhe atyre informative, si dhe i institucioneve qeveritare që mbikëqyrin këto shërbime, garanton llogaridhënie demokratike, dhe janë si më poshtë:

1. Kuvendi duhet të ngrejë një komision ose një nënkomision të përhershëm, ku ky i dyti parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të mbikëqyrur shërbimet informative dhe ato të sigurisë dhe organizata të tjera që mbledhin dhe përdorin informacione sekrete. Ka pasur më parë një nënkomision të vogël, i cili hetonte dhe mbikëqyrte Shërbimin Shtetëror Informativ, por ky proces aktualisht nuk ndiqet (dhe nuk është ndjekur për vite me radhë). Shërbimet kryesore që duhet të mbulohen nga (nën)komisioni janë Shërbimi Shtetëror Informativ dhe Shërbimi Informativ Ushtarak, së bashku me organe të Kryeministrit, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrisë së Brendshme, Punëve të Jashtme dhe Financës. Kjo listë, në fakt, përfshin të gjitha organet që mund të kërkojnë përgjimin e komunikimeve dhe që kryejnë veprime të tjera të miratuara nga Prokurori i Përgjithshëm, si dhe organe që administrojnë sistemin dhe që përdorin informacionin e mbledhur në këtë mënyrë.

2. Nënkomisioni mund të kryejë hetime të veçanta, sipas nevojës, por duhet të fokusohet në sa më poshtë:

a) ligjshmërinë (dhe proporcionalitetin) e aktiviteteve, pavarësisht nëse ndiqen apo jo procedurat e rena dakord (mund të përfshihet hetimi i ankesave nga individët), të verifikojnë

nëse po ushtrohet kontrolli i duhur demokratik nga ekzekutivi dhe se nuk po shkelen të drejtat e individit;

b) përdorimin e duhur të burimeve financiare dhe mbajtjen e përgjegjësisë;

c) hetimin e mënyrave të mbledhjes së informacionit, përdorimin dhe mbrojtjen e tij, duke shërbyer kështu si një mekanizëm që ofron siguri për popullsinë e gjerë apo që heton të metat apo abuzimet;

d) dhënien e rekomandimeve në lidhje me efektivitetin, prioritetet dhe fushën e përgjegjësisë së shërbimeve/organizatave dhe ushtrimin e kontrollit demokratik nga qeveria ndaj shërbimeve/organizatave.

3. (Nën)komisioni nuk duhet të përfshihet në procese gjyqësore apo të mbikëqyrë mbledhjen e provave të përdorura në ndjekjet penale sipas kodit penal. (Nën)komisioni nuk duhet, gjithashtu, as të 'miratojë' operacione – pasi kjo duhet të mbetet kompetencë e ekzekutivit – dhe as nuk duhet të ketë mundësi të kërkojë informacion në lidhje me operacionet që janë në proces apo informacion në lidhje me punonjësit apo agjentët.

4. (Nën)komisioni duhet të ketë mundësi të sigurojë prova verbale dhe me shkrim nga:

- a. Ministrat përgjegjës për shërbimet/organizatat përkatëse, në mënyrë që ata të japin llogari për kontrollin demokratik të shërbimeve/organizatave, funksioneve dhe veprimeve të tyre;
- b. Prokurori i Përgjithshëm, për autorizimin e mbledhjes së informacioneve sekrete;
- c. Drejtorët/Kryetarët e shërbimeve/organizatave;
- d. Inspektorët e Përgjithshëm dhe nga organe të tjera të brendshme mbikëqyrëse, si nga Kontrolli i Lartë i Shtetit; dhe
- e. Përdoruesit e informacioneve të mbledhura dhe vlerësimeve të tyre, duke përfshirë edhe ministrat.

Për të dhënë prova, mund të ftohen edhe të tjerë, si p.sh. shoqëria civile dhe anëtarë të shërbimeve/organizatave, por pa qenë të detyruar.

5. (Nën)komisioni nuk duhet të komprometojë Sekretet Shtetërore. Duhet marrë masa për mbrojtjen e të dhënave sekrete, në mënyrë që Ministrat dhe zyrtarët të flasin hapur me (nën)komisionin dhe të japin informacion/prova. Anëtarët e (nën)komisionit duhet të emërohen nga grupet përkatëse parlamentare dhe të bien dakord për rregullat e sigurisë, duke nënshkruar një dokument ku shprehet se ata i kuptojnë rregullat e konfidencialitetit, duke përfshirë edhe mundësinë e sanksioneve penale në rast shkeljeje të tyre (por nuk duhet domosdoshmërisht që ata të kalojnë nëpër një proces zyrtar "verifikimi dhe certifikimi"). I gjithë stafi duhet të jetë i pajisur me certifikata zyrtare sigurie. (Nën)komisionit duhet t'i sigurohet një ambient i sigurt. Në raste të veçanta mund të mbahen seanca dëgjimore me dyer të hapura, por zakonisht të gjitha takimet duhet të jenë të mbyllura pa u dhënë të drejtë hyrjeje as deputetëve të tjerë dhe as anëtarëve të Këshillit të Ministrave.

6. (Nën)komisioni duhet të raportojë, të paktën një herë në vit, në Kuvend dhe rrjedhimisht edhe para publikut të gjerë dhe raportet e tyre duhet të diskutohen në seancë plenare. Vendimi përfundimtar lidhur me atë çka mund të bëhet publike i takon (nën)komisionit, i cili duhet të veprojë me përgjegjësi dhe të mos vërë në rrezik operacionet apo marrëdhëniet ndërkombëtare/multi-kombëtare me vende apo organizata të tjera. Raportet mund të çklasifikohen ose prej tyre mund të hiqen pjesë që klasifikohen si sekret para se ato të bëhen publike – në këtë rast një kopje e raportit të plotë i dorëzohet Kryetarit të Parlamentit, Presidentit, Kryeministrit, Ministrave përkatës dhe shërbimeve/organizatave.

7. (Nën)komisioni duhet të jetë në gjendje që pas identifikimit të problemeve, t'ia bëjë ato të ditur ekzekutivit; këtu mund të përfshihet informimi në kohën e duhur i Presidentit,

Kryeministrit, Ministrave dhe shërbimeve/organizatave përkatëse, si dhe i Kryetarit të Parlamentit.

8. E mira është që (nën)komisioni t'i marrë të gjitha vendimet me konsensus, por nëse nevojitet të votohet, ky proces duhet të rregullohet me ligj. Po kështu, nëse nuk bihet dakord me konsensus për një raport të caktuar, atëherë si shumica, ashtu edhe pakica, duhet të kenë mundësi të bëjnë publike konkluzionet e tyre.

Në bazë të këtyre rekomandimeve, Prezenca e OSBE-së në Tiranë sugjeron që të veprohet si më poshtë:

9. Të merren hapa për të garantuar që Këshilli i Ministrave të hartojë një projektligj dhe t'ia dërgojë Kuvendit sa më shpejt të jetë e mundur, duke respektuar procesin e duhur të konsultimit.

10. Për përmirësimin e projektligjit do të duhet të konsultohen palët e interesuara, ku përfshihen edhe qeveria dhe shoqëria civile, dhe të organizohen debate publike dhe tryeza të rrumbullakëta. Mbështetja e qeverisë, krahas interesit të parlamentit, do të garantonte miratimin e këtij ligji.

Përveç sa përmendet në pikën 5, Prezenca vë në dukje se mund të nevojiten ndryshime të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, në mënyrë që të bëhet e mundur ndjekja penale e atyre që mund të cenojnë konfidencialitetin e informacioneve të marra nga (nën)komisioni parlamentar. Në Kodin Penal aktual, parashikohen dispozita në bazë të të cilave mund të fillojë ndjekja penale për zbulimin e paautorizuar të informacionit (neni 248 “shpërdorimi i detyrës” dhe neni 295/a “zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete”). Rekomandimi ynë është që të shihet nëse këto janë të mjaftueshme për të trajtuar të gjitha çështjet që mund të lindin në këtë fushë.